



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al
www.qpz.gov.al

Nr.3

22 janar

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Udhëzim i MF nr.3, datë 19.1.2009	Për rastet e shitjes, transferimit të aksioneve të shoqërive të licencuara të lojërave të fatit.....	21
Udhëzim i MF nr.4, datë 19.1.2009	Për përcaktimin e fondit të ngurtësimit për garancinë e fituesit/fituesve në lojërat e fatit.....	22
Udhëzim i MF nr.5, datë 19.1.2009	Për procedurat e hapjes dhe mbylljes së sallave të lojërave basteve sportive, kazinove elektronike, bingove tradicionale.....	23
Udhëzim i MF nr.6, datë 19.1.2009	Për paralajmërimin e lojtarëve dhe ekspozimin e lojërave të fatit ndaj institucioneve fetare, shëndetësore dhe arsimore	24
	Ndreqje gabimi	25

UDHËZIM
Nr.3, datë 19.1.2009

**PËR RASTET E SHITJES, TRANSFERIMIT TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË
LICENCUARA TË LOJËRAVE TË FATIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 10/5 të ligjit nr.10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Shoqëritë e licencuara për zhvillimin e lojërave të fatit, përpara se të transferojnë, shesin, të lënë peng dhe çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre, duhet të njoftojnë paraprakisht NJMLF-në.

I. Shoqëritë e licencuara në fushën e lojërave të fatit duhet të paraqesin panë NJMLF-së për shitjen e aksioneve të tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Njoftim për shitjen e aksioneve të shoqërisë transferimin apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre.

2. Dokumentin që shoqëria nuk është në proces likuidimi apo falimentimi.

3. Vendimin e organeve të shoqërisë që miratojnë shitjen, transferimin apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre, sipas dispozitave që ka në statut.

4. Vërtetim nga organet tatimore, sipas legjislacionit në fuqi, që shoqëria nuk ka detyrime ndaj shtetit.

II. Subjektet që do të blejnë aksionet e shoqërive të licencuara në fushën e lojërave të fatit të paraqesin pranë Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Vendimin e regjistrimit në gjykatë si person juridik me objekt veprimtarie në fushën e lojërave të fatit, aktin e themelimit dhe statusin e shoqërisë.

2. Deklaratat e burimit të kapitalit, shumave të tjera që do të investohen për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit.

III. Shoqëritë e licencuara për ushtrim veprimtarie për kazino dhe lotari kombëtare, për shitjen e aksioneve, transferimit, lënies peng apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre, të paraqesin në NJMLF këto dokumente:

1. Njoftim për shitjen e aksioneve të shoqërisë, transferimin, lënien peng apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre.

2. Vendimin e organeve të shoqërisë që miratojnë shitjen, transferimin, lënien peng apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre, sipas dispozitave që ka në statut.

3. Vërtetim nga organet tatimore, sipas legjislacionit në fuqi, që shoqëria nuk ka detyrime ndaj shteti.

IV. Subjekti që do të blejë aksionet e shoqërisë në veprimtari kazino apo lotari kombëtare, duhet të paraqesë në NJMLF këto dokumente:

1. Dokumentet origjinale apo të noterizuara, që vërtetojnë se ai është i organizuar në formë shoqërisë apo grupime shoqërisë, me objekt veprimtarie në fushën e kazinove apo lotarive kombëtare, si dhe aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.

2. Dokumente që shoqëria nuk është në proces likuidimi, falimentimi a ndonjë proces të ngjashëm në vendin ku kanë selinë qendrore, apo në vende të tjera ku ushtron veprimtarinë.

3. Një kopje të noterizuar të lejes për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kazinove apo lotarisë kombëtare, nëse ka, të dhënë nga organi përkatës i vendit ku ato kanë selinë qendrore, nëse një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni i shtetit ku kanë selinë qendrore apo të vendeve të tjera ku ushtrojnë veprimtarinë në fushën e kazinove apo lotarisë kombëtare.

4. Deklarata për burimin e kapitalit dhe të shumave të tjera që do të investohen për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kazinove në vendin tonë, madhësinë e kapitalit të paktën në të njëjtën nivel me shoqërinë, e cila ka fituar të drejtën e lejes për veprimtari kazinoje apo lojtari kombëtare.

5. Vërtetim nga organet përkatëse për detyrimet e natyrës fiskale apo të natyrave të ngjashme kundrejt shtetit e tyre apo shteteve të tjera ku ato ushtrojnë veprimtarinë si për shoqërinë, edhe për çdo subjekt në rast grupimi.

6. Dhënia ose marrja me qira e lojërave elektronike me fitim në çast nuk lejohet.
Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.4, datë 19.1.2009

PËR PËRCAKTIMIN E FONDIT TË NGURTËSIMIT PËR GARANCINË E
FITUESIT/FITUESVE NË LOJËRAT E FATIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 42 të ligjit nr.10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”,

UDHËZOJ:

Organizatorët e lojërave të fatit, për garantimin e fituesit/fituesve të lojërave të fatit, duhet të ngurtësojnë në një llogari të veçantë bankare, një shumë të caktuar si më poshtë vijon:

1.a) Për bingo, për rrethet e kategorisë së parë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.

- Për rrethet e kategorisë së dytë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

- Për rrethet e aktegorisë së tretë, fondi ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milionë) lekë.

- Për çdo filial dhe sallë të hapur në territorin e Republikës së Shqipërisë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milionë) lekë.

2.Për bastet sportive dhe baste për gara në pistë:

a) Organizatori të garantojë për çdo lojë, fituesin/fituesit e lojërave të fatit, me kapitalin themeltar të shoqërisë, si dhe me fondin e ngurtësimit në masën 7 000 000 (shtatë milionë) lekë.

3.Për lotarinë kombëtare dhe për kazinotë:

a)Organizatori të garantojë për çdo lojë, fituesin/fituesit e lojërave të fatit, me kapitalin themeltar të shoqërisë, si dhe me fondin e ngurtësimit në masën 20 000 000 (njëzet milionë lekë).

4.Për kazinotë elektronike, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo makinë elektronike, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

5.NJMLF-ja i propozon Ministrin të Financave zhbllokimin e këtij fondi, me kërkesë të organizatorit të lojërave, në rast se vërtetohet se ky i fundit nuk ka detyrime tatimore, nuk ka gjaba të pashlyera, si dhe kur mbyll veprimtarinë e tij, të vërtetuara këto nga organet shetërore përkatëse.

6.Ngurtësimi duhet të jetë në formën e garancisë bankare të pakushtëzuar.

Ky urdhër hyn në fuqi me botimin e Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.5, datë 19.1.2009

“PËR PROCEDURAT E HAPJES DHE MBYLLJES SË SALLAVE TË LOJËRAVE BASTEVE SPORTIVE, KAZINOVE ELEKTRONIKE, BINGOVE TRADICIONALE”

Në mbështetje të nenit 102/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në zbatim të nenit 10 pika 4, germa (dh) të ligjit nr.10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit” Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Shoqëritë e lojërave të fatit për kategoritë bingo tradicionale, kazino elektronike, për hapjen e sallave të reja të lojërave të fatit duhet të paraqesin pranë NJMLF-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Njoftim për hapjen e sallës dhe adresën e saktë të saj;

b) Të dhënat e mëposhtme për personelin e sallës:

b.1. Certifikatë personale të personelit;

b.2. Vërtetim të gjendjes gjyqësore të personelit

b.3. Dëshmi kualifikimi të personelit.

c. Kontratë pune të personelit:

c.1. Garancinë për fituesin e lojës;

c.2. Vërtetimin e pronësisë ose kontratën e qirasë për sallën e re;

c.3. Vërtetim pronësie, deklaratë zhdoganimi dhe certifikatë origjine për pajisjet e përdorura për lojra fati;

c.4. Rregulloret përkatëse për lojërat që do të zhvillohen në këto salla.

2. Shoqëritë e lojërave të fatit, për hapjen e pikave të lojërave të fatit baste sportive duhet të paraqesin në NJMLF dokumentacionin e mëposhtëm:

a) njoftimin për hapjen e pikave dhe adresën e saktë të saj;

b) të dhënat e mëposhtme për personelin e sallës:

b.1. certifikatë personale të personelit;

b.2. vërtetim të gjendjes gjyqësore të personelit;

b.3. dëshmi kualifikimi të personelit;

b.4. kontratë pune të personelit.

c) Vërtetimin e pronësisë së pikave të lojërave të fatit sportive ose kontratën e qirasë.

3. Shoqëritë e lojërave të fatit për mbylljen e sallave të bingove, kazinove elektronike dhe të pikave të lojërave të fatit sportive duhet të paraqesin në NJMLF dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesë për mbylljen e sallës.

b) Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore.

c) Zgjidhjen e kontratës për ambientet e marra me qira.

4. Shoqëritë që ushtrojnë aktivitet lojëra fati, për transferimin e automateve të miratuara nga sallat ekzistuese në salla të tjera duhet të paraqesin në NJMLF dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesë për transferimin e automateve.

b) Arsytet e transferimit të automateve.

5. Shoqëritë e lojërave të fatit detyrohen të njoftojnë NJMLF-në, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, degën e tatim-taksave të rrethit përkatës, 30 ditë përpara për transferimin, shtimin dhe heqjen e automateve elektronike.

Në rast se shoqëritë e lojërave të fatit nuk paraqesin dokumentacionin e parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të udhëzimit, nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë pa e plotësuar këtë dokumentacion sipas kërkesave së këtij udhëzimi.

6. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.6, datë 19.1.2009

PËR PARALAJMËRIMIN E LOJTARËVE DHE EKSPLOZIMIN E LOJRAVE TË FATIT NDAJ INSTITUCIONEVE FETARE, SHËNDETËSORE DHE ARSIMORE

Në mbështetje të nenit 102/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në zbatim të nenit 7 pika 3 të ligjit nr.10033, datë 11.2.2008 “Për lojrat e fatit” Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në mjedisin ku luhen lojërat e fatit duhet të ekspozohet gjithmonë një tabelë e dukshme, paralajmëruese për lojtarët me këtë përmbajtje:

a. “Marrja pjesë në lojërat e fatit mund të ndikojë negativisht në gjendjen ekonomike të lojtarit”.

2. Hyrja në mjediset ku zhvillohen lojra fati ose reklamimi i vendosur jashtë ambjenteve ku zhvillohen këto lojra:

a. Duhet të jenë jo më afër se 40 metra nga godinat e institucioneve arsimore, shëndetësore ose fetare apo hyrja për në këto institucione, me kusht që këto institucione të jenë përballë mjediseve ku zhvillohen lojëra fati dhe të ekspozuara (shihen lirshëm pa pengesa) ndaj tyre;

b. Duhet të jenë jo më afër se 15 metra nga hyrja për në institucionet arsimore, shëndetësore ose fetare në rastet kur reklama apo hyrja për në mjediset ku luhen lojra fati ndodhet në të njëjtën rrugë që të çon në hyrjen e institucioneve arsimore, shëndetësore ose fetare.

c. Nuk mund të jenë në të njëjtën rrugë që të çon në institucione arsimore, shëndetësore apo fetare në rast se rruga (për këmbësorë ose automjete) që të çon në këto institucione është e vetme.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE

Ridvan Bode

Ndreqje gabimi

Në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë“ i botuar në Fletoren Zyrtare nr.189, datë 29.12.2008 të bëhen këto ndreqje gabimesh:

1. Në nenin 19 pika 2, fjalia e parë, shifra “14” zëvendësohet me shifrën “18”.
2. Në nenin 24 pika 1 shkronja a, shifra “165” zëvendësohet me fjalët “166 pika 3”.
3. Në nenin 24 pika 1 shkronja b, shifra “122” zëvendësohet me shifrën “123”.
4. Në nenin 53 shkronja a, shifra “52” zëvendësohet me shifrën “59”.
5. Në nenin 62 pika 2, fjalia e parë, fjalët “shkronjën “a” zëvendësohet me fjalët shkronjën

“b”.

6. Në nenin 84 pika 2 shkronja a, fjalia e parë shifra “80” zëvendësohet me shifrën 81.
7. Në nenin 91 pika 5, shifra romake “XIV” zëvendësohet me shifrën romake “XIII”.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 22.1.2009
Doli nga shtypi më 22.1.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 8 lekë